

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214/30400-26-4777-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **FURNIZIM ME SPALETA RITENDER**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	FWRDZ L.L.C.
NUI	812173889
Adresa	M idrizi pn
Vendi	Gjilan
Kodi postar	60000
Numri Telefonit	049706506
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Brikena Shahiqi
Adresa elektronike	b_shahiqi@outlook.com
Data e parashtrimit të ankesës	13.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

FURNIZIM ME SPALETA RITENDER

Ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe lënien në fuqi të njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit ‘FURNIZIM ME SPALETA – RITENDER’, nr. 214/30400-26-4777-1-2-1. Kërkohet anulimi i vendimit të kontestuar dhe kthimi i aktivitetit në rivlerësim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

FWRDZ L.L.C. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit ‘FURNIZIM ME SPALETA – RITENDER’. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka lënë në fuqi njoftimin për anulimin e aktivitetit. Vendimi i AK-së bashkëngjitet si provë në këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Pretendohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur këto dispozita:

Neni 7 i LPP-së - parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës.

Neni 59, veçanërisht paragrafi 2, i LPP-së - ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, përfshirë mundësinë e kërimit të sqarimeve për aspektet e tenderit pa ndryshuar aspektet materiale të tij.

Neni 38.1 dhe 38.4 i Rregullores për Prokurimin Publik - lidhur me sqarimin e tenderëve dhe qartësimin e deklaratave/certifikatave të paqarta.

Neni 40.2 i Rregullores për Prokurimin Publik - tenderët duhet të vlerësohen sipas kërkesave dhe kritereve të përcaktuara paraprakisht në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit dhe nuk lejohen kërkesa, kritere apo specifikime të reja gjatë vlerësimit.

Neni 40.12 i Rregullores për Prokurimin Publik - tenderuesi nuk duhet të diskualifikohet ose përjashtohet mbi bazën e një kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në Njoftimin për Kontratë/Dosjen e Tenderit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

FWRDZ L.L.C. kundërshton Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 06.08.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim dhe është lënë në fuqi njoftimi i AK-se për anulimin e aktivitetit të prokurimit FURNIZIM ME SPALETA - RITENDER.

CFARE KERKON SAKTE DOSJA E TENDERIT

Dosja e Tenderit, të kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional, i ndan qartë mostrat nga atestet laboratorike.

1. Kërkesa 1 kërkon mostra për secilin artikull sipas specifikimeve teknike të Aneksit 1.
2. Kërkesa 2 kërkon që Operatori Ekonomik të dorëzojë atestet e kryera për artikujt nr. 4 dhe 8 nga një laborator i akredituar sipas specifikimeve teknike të Aneksit 1.
3. Dëshmi 2 kërkon dorëzimin e atesteve të kryera nga laborator i akredituar për artikujt nr. 4 dhe 8 sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Në specifikimet teknike të Aneksit 1 është kërkuar: Materialet themelore, ngjyrat dhe materialet me të cilat punohen/qendisen spaletat kërkohej të deshmohen me atestet laboratorike përkatëse. Ky formulim tregon se AK ka kërkuar ateste për materialet

themelore/baze dhe jo ateste per produktin final apo per secilen moster fizike te dorezuar.

Ne Dosjen e Tenderit nuk eshte percaktuar date skadence e atesteve, nuk thuhet se ato duhet te jene leshuar posacerisht per kete numer te ri te prokurimit dhe nuk thuhet se mostra fizike e dorezuar ne kete ritender duhet domosdoshmerisht te jete pikerisht mostra fizike mbi te cilen eshte kryer testi laboratorik. Ajo qe eshte relevante per atestet eshte materiali dhe karakteristikat teknike te tij.

Pikerisht kjo eshte ceshtja qendrore e ankeses: oferta duhet te vleresohet sipas kerkesave te shkruara ne Dosjen e Tenderit dhe jo sipas nje kushti shtese te nxjerre gjate vleresimit.

1. Pika 1 e AK-se - mostra e re eshte produkt i modifikuar

AK thote se mostra e procedures se kaluar kishte deshtuar ne elementet vizuale, perkatesisht te ylli dhe vija e grades Kadet, dhe se mostra e procedures se re paraqet produkt te modifikuar. Nga kjo AK perfundon se raporti laboratorik i nje mostre qe ka deshtuar nuk mund te certifikojte mostren e re te modifikuar.

Kundershtimi: PROFILAB ka sqaruar zyrtarisht se, pervec rasteve kur kjo perfshihet posacerisht ne fushen e testimit, ekzaminimet laboratorike nuk vleresojne dhe nuk certifikojne pamjen vizuale, elementet dekorative, modelet e qendisjes apo karakteristika te tjera estetike.

PROFILAB ka sqaruar me tej se, kur produktet prodhohen me te njejtin material, perberje identike, specifikime teknike identike dhe te njejtin proces prodhimi, ndryshimet vetem vizuale nuk perbejne deshmi laboratorike se karakteristikat teknike te testuara kane ndryshuar.

Ne rastin konkret, korrigjimet e bera ne mostren e procedures aktuale kane qene ne elementet vizuale te konstatuara ne proceduren e meparshme, ndersa materiali i perdorur eshte i njejti material me te njejten perberje dhe karakteristika teknike te materialit te testuar ne laborator.

Prandaj, korrigjimi i yllit ose i vijes se grades nuk mund te barazohet automatikisht me ndryshim te materialit ose te parametrave laboratorike pa nje baze teknike qe e provon kete.

2. Pika 2 e AK-se - raportet nuk ishin aprovuara ne heshtje

AK thote se fakti qe raportet laboratorike nuk jane kontestuar ne proceduren e meparshme nuk nenkupton aprovim ne heshtje, pasi vleresimi ishte ndalur pas konstatimit te mosperputhjeve te mostres fizike.

Kundershtimi: Ankuesi nuk pretendon se raportet laboratorike jane aprovuara ne heshtje. Rendesia e procedures se meparshme qendron ne faktin se OE nuk eshte eliminuar dhe as nuk eshte njoftuar per ndonje problem lidhur me metoden ISO 3801 apo me fushen e akreditimit te laboratorit. Arsytet e eliminimit ne proceduren e meparshme kane qene te tjera, sic deshmohet nga vendimi i meparshem i AK-se, i cili eshte bashkengjitur si prove ne kete ankese.

Sikur ceshtja lidhur me metoden ISO 3801 apo fushen e akreditimit te ishte evidentuar dhe komunikuar nga AK ne proceduren e meparshme, OE do te kishte pasur mundesi t'i drejtohej menjehere laboratorit per sqarimin dhe korrigjimin e gabimit administrativ. Ne ate rast, ne proceduren aktuale OE do te kishte qene ne gjendje ta paraqiste raportin me shenimin e sakte te metodës EN ISO 12127:2014.

OE nuk ka pasur mundesi te jete ne dijeni per nje gabim administrativ te bere nga laboratorit dhe te pakomunikuar me pare. Menjehere pasi kjo ceshtje eshte ngritur ne proceduren aktuale, OE i eshte drejtuar laboratorit per sqarim. PROFILAB ka konfirmuar

zyrtarisht se shenimi i metodes ISO 3801 Part III ne raportin T102557-2 ka qene rezultat i nje gabimi administrativ dhe se gjate testimit eshte perdorur metoda EN ISO 12127:2014.

Ky sqarim nuk paraqet ndryshim te ofertes dhe as zevendesim te nje dokumenti qe ka munguar ne oferte, por sqarim nga vete leshuesi lidhur me permbajtjen teknike te nje raporti laboratorik ekzistues.

Pavaresisht kesaj, argumenti juridik kryesor mbetet se Dosja e Tenderit kerkon ateste te kryera nga laborator i akredituar per artikujt nr. 4 dhe 8 sipas specifikimeve teknike, por nuk percakton date skadence te atesteve, ritestim te detyrueshem apo kusht qe atestet te jene leshuar posacerisht per kete procedure te ritenderit.

Per rrjedhoje, fakti se raportet nuk jane kontestuar ne proceduren e meparshme nuk perdoret nga ankuesi si pretendim per aprovim ne heshtje, por si rrethane faktike qe deshmon se OE nuk ka qene me pare i njoftuar per ceshtjen konkrete te metodes ISO 3801/akreditimit dhe nuk ka pasur mundesi ta adresojte ate para procedures aktuale.

Prandaj, edhe nese pranohet plotesisht arsyetimi i AK-se se nuk ka pasur aprovim ne heshtje, kjo nuk zgjidh pyetjen kryesore: cila dispozite e Dosjes se Tenderit e ben te detyrueshem raportin e ri ose ritestimin?

3. Pika 3 e AK-se - Neni 59 dhe "siguria teknike"

AK pranon shprehimisht ne vendim se Dosja e Tenderit nuk specifikon date skadence per raportet laboratorike, por argumenton se qellimi i raporteve eshte te garantojne perputhshmerine e produktit aktual dhe se perdorimi i atestit T102557-2 nga procedura e meparshme cenon sigurine teknike.

Kundershtimi: Pranimi i AK-se se DT nuk specifikon date skadence eshte i rendesishem, por nuk duhet interpretuar si pranim nga AK se DT nuk kerkon raport te ri. Kjo e fundit eshte pretendimi i ankuesit dhe mbeshetet ne tekstin konkret te "Kerkeses 2 / Deshmise 2", ku kerkohen ateste te kryera nga laborator i akredituar sipas specifikimeve teknike, pa u percaktuar nje kerkese e tille shtese.

Ne specifikimet teknike te Aneksit 1 eshte kerkuar qe materialet themelore, ngjyrat dhe materialet me te cilat punohen/qendisen spaletat te deshmohej me atestet laboratorike perkatese. Ky formulim tregon se AK ka kerkuar ateste per materialet themelore/baze dhe jo ateste per produktin final apo per secilen moster fizike. Per rrjedhoje, eliminimi i ofertes sone mbi kete baze eshte ne kundershtim me kriteret e percaktuara paraprakisht nga vete Autoriteti Kontraktues.

Neni 59 i LPP-se rregullon ekzaminimin, vleresimin dhe krahasimin e tendereve. Paragrafi 2 lejon qe AK te kerkoje me shkrim sqarim per nje aspekt te tenderit, pa ndryshuar aspektet materiale. Ky mekanizem eshte vecanerisht relevant kur AK ka dyshim per kuptimin ose lidhjen e nje dokumenti ekzistues.

4. Konstatimi i AK-se se raporti duhet te vertetoje "produktin e dorezuar sot"

AK deklaroi se ka per detyre te sigurohet qe raporti i akredituar verteton saktesisht produktin e dorezuar ne proceduren aktuale dhe jo nje variant te kaluar.

Kundershtimi: Ankuesi nuk mohon qe raporti laboratorik vlen per materialin e testuar dhe se rezultatet e laboratorit lidhen me mostren e testuar. Ceshtja eshte tjeter: Dosja e Tenderit i ka parapare si kerkese te vecanta dorezimin e mostrave dhe dorezimin e

atesteve laboratorike.

Ne tekstin e Kerkeses 2/Deshmise 2 nuk eshte percaktuar qe mostra fizike e dorezuar ne tender duhet te jete pikerisht e njejta cope qe eshte testuar ne laborator. Ne rastin konkret, materiali i perdorur ne mostren e dorezuar ne proceduren aktuale eshte i njejti material, me te njejten perberje dhe karakteristika teknike, ndersa ndryshimet e bera kane qene vetem ne elementet vizuale te produktit.

Nese AK e konsideron si kusht eliminues qe mostra tenderuese te jete pikerisht e njejta cope fizike qe i eshte nenshtuar testimit laboratorik, nje kusht i tille duhet te kishte qene i percaktuar paraprakisht ne dokumentacionin e tenderit.

5. Konstatimi i AK-se se raporti nuk garanton qe mostrat e tanishme jane testuar

AK perfundon se raporti i dorezuar nuk garanton qe mostrat e tanishme i jane nenshtuar testimit dhe, per kete arsye, konsideron se OE nuk ka deshmuar plotesisht perputhshmerine.

Kundershtimi: PROFI LAB konfirmon se gjate testimit mostrat tekstile, varesisht nga metodat dhe standardet, priten, cmontohen, lahen, u nenshtrohen testeve fizike dhe mekanike dhe ndryshohen ne menyre te perhershme. Si rrjedhoje, mostrat e testuara nuk jane te pershtatshme per perdorim ose dorezim te mevonshem si mostra tenderuese.

Edhe Neni 37.6 i Rregullores per Prokurimin Publik e njeh shprehimisht mundesine qe testi teknik ta shkaterroje mostren, duke parapare kthimin e mostrave te tenderuesve jo te suksesshem vetem nese ato ende ekzistojne fizikisht.

Kjo e perforcon dallimin ndermjet funksionit te mostres tenderuese dhe funksionit te testimit laboratorik. Mostra fizike e dorezuar ne tender nuk ka pse te jete e njejta cope fizike e konsumuar apo ndryshuar gjate testimit laboratorik. Relevante eshte qe materiali i perdorur te jete i njejte dhe te kete te njejta karakteristika teknike te deshmuara me atestet laboratorike.

Megjithate, ankuesi nuk kerkon qe OSHP te supozoje automatikisht identitet teknik; kerkon qe te zbatohet kerkesa reale e Dosjes dhe te vleresohen sqarimet e laboratorit mbi faktet teknike.

AK ka kerkuar ateste per materialet baze dhe ne asnje pjese te Dosjes se Tenderit nuk ka kerkuar ateste per produktin final. Per rrjedhoje, elimini i ofertes sone mbi nje kerkese te tille te paspecifikuar eshte ne kundërshtim me kriteret e percaktuara ne Dosjen e Tenderit.

MOSKERKIMI I SQARIMIT PARA VENDIMIT

Rregullorja per Prokurimin Publik, Neni 38, parashikon mekanizmin e sqarimit te tendereve. Neni 38.1 lejon kerkesen individuale per sqarim, ndersa Neni 38.4 parashikon kerkimin e informacionit me qellim te qartesimit te permbajtjes se deklarave te paqarta dhe certifikatave te perfshira ne tender.

Ne rastin konkret, AK nuk ka kerkuar nga FWRDZ L.L.C. sqarim lidhur me daten, lidhjen teknike te raporteve me materialin, natyren e ndryshimeve vizuale ose metoden e shenuar ne raport. Kjo eshte vecanerisht relevante sepse sqarimet e marra me pas nga vete laborator i adresojne drejtperdrejt keto ceshtje pa ndryshuar cmimin, produktin e ofertuar

ose ndonje kusht material te tenderit.

Keto deklarata nuk paraqiten si zevendesim i nje dokumenti qe ka munguar ne oferte, por si sqarim nga leshuesi i dokumenteve ekzistuese per permbajtjen dhe kuptimin teknik te tyre.

NENI 40.2 DHE 40.12 I RREGULLORES - PIKA KRYESORE JURIDIKE

Neni 40.2 i Rregullores per Prokurimin Publik kerkon qe tenderet te ekzaminohen, vleresohen dhe krahasohen ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne Njoftimin per Kontrate/Dosjen e Tenderit dhe ndalon shtimin e kerkesave, kriterëve ose specifikimeve te reja gjate vleresimit.

Neni 40.12 percakton se tenderuesi nuk do te diskualifikohet ose perjashtohet nga procedura ne baze te nje kerkese apo kriteri qe nuk eshte specifikuar ne Njoftimin per Kontrate/Dosjen e Tenderit.

Ne rastin konkret, Dosja kerkon ateste te kryera nga laborator i akredituar sipas specifikimeve teknike per artikujt nr. 4 dhe 8. Nese AK e kushtezon pranueshmerine me nje raport te ri, me testim te kryer posacerisht per kete numer te ritenderit ose me kushtin qe mostra tenderuese te jete pikerisht e njejta cope fizike e testuar ne laborator, duhet te tregojë se ku eshte percaktuar ky kusht ne Dosjen e Tenderit.

DEKLARATA ZYRTARE E PROFI LAB MBI DATEN DHE NDRYSHIMET VIZUALE

PROFI LAB ka konfirmuar se data e leshimit te raportit laboratorik, ne vetvete, nuk perben deshmi teknike se karakteristikat teknike te testuara kane ndryshuar dhe se nje percaktim mbi karakteristikat teknike mund te behet vetem permes ekzaminimit laboratorik sipas standardeve perkatese.

Ky sqarim lidhet drejtperdrejt me arsyetimin e AK-se: data e raportit mund te jete fakt relevant, por nuk provon vetvetiu se materiali ose parametrat teknike te produktit kane ndryshuar.

SQARIMI SHITES PER RAPORTIN T102557-2

PROFI LAB ka leshuar edhe nje deklarate te posacme lidhur me raportin T102557-2. Laboratori konfirmon se shenimi i metodës ISO 3801 Part III per masen siperfaqesore ka qene rezultat i nje gabimi administrativ dhe se gjate testimit eshte perdorur metoda EN ISO 12127:2014.

Laboratori sqaron se, sipas vleresimit te tij teknik, standardet e permendura nuk kane dallime ne metodologji, dallime teknike ose ne procedurat e testimit dhe se rezultatet e fituara jane te njejta.

Ky dokument paraqitet si sqarim i leshuesit te raportit per nje raport ekzistues dhe jo si ndryshim i ofertes.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Anulimi i aktivitetit të prokurimit dhe mosvlerësimi i drejtë i ofertës së FWRDZ

L.L.C. i shkakton dhe rrezikon t'i shkaktojë Operatorit Ekonomik dëm material, përfshirë shpenzimet e bëra për përgatitjen dhe pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit, sigurimin e mostrave, testimet laboratorike, dokumentacionin dhe shpenzimet e tjera të lidhura me ofertimin. Gjithashtu, si pasojë e vendimit të kontestuar, FWRDZ L.L.C. humb mundësinë për vlerësim të ligjshëm të ofertës dhe për fitimin e kontratës. Për këtë arsye kërkohet anulimi i vendimit të kontestuar dhe kthimi i aktivitetit të prokurimit në rivlerësim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*